## BACHELOR NË PSIKOLOGJI

*(me profil Shëndet Mendor)*

## OBJEKTIVAT E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Ky program studimi synon përgatitjen e psikologëve me njohuri të përgjithshme në fushën e psikologjisë duke filluar që nga teoritë bazë mbi rritjen dhe zhvillimin njerëzor, sjelljen sociale dhe personalitetin, të menduarit dhe të nxënit dhe deri tek vlerësimi dhe trajtimi i psikopatologjisë dhe problematikave të ndryshme psiko-sociale. Programi synon të mundësojë një karrierë të mëtejshme akademike ose profesionale në një nga specializimet e fushës së psikologjisë.

## REZULTATET E TË NXËNIT

Në përfundim të studimeve, studentët do të jenë në gjendje të:

- Përshkruajnë teoritë mbi personalitetin dhe zhvillimin njerëzor;
- Përshkruajnë rolin dhe kompetencat e psikologut në organizata, shkolla apo sistemin gjyqësor;
- Kategorizojnë çrregullimet kryesore psikopatologjike;
- Aplikojnë teoritë e këshillimit në analizën e rasteve studimore;
- Analizojnë ndërveprimin biologji-person-mjedis në kontekstin e shëndetit dhe sëmundjes;
- Analizojnë teorikisht një rast studimor;
- Përshkruajnë rolin dhe kompetencat e psikologut klinik;
- Përzgjedhin instrumentat e duhur në vlerësimin psikologjik;
- Identifikojnë faktorët dhe modelet teorike që shpjegojnë sjelljet shëndetësore.

## MUNDËSITË E PUNËSIMIT

Pas përfundimit të studimeve, të diplomuarit mund të kenë akses të drejtpërdrejtë në tregun e punës në hapësirat e mëposhtme:

- Psikolog me formim të përgjithshëm pranë administratës qendrore apo vendore (nëse parashikohet në organigramën përkatese të institucioneve);
- Asistent-psikolog me formim të përgjithshëm pranë gjykatave dhe institucione të riedukimit të të miturve dhe personave të dënuar;
- Asistent-psikolog pranë Institucioneve publike të birësimit të fëmijëve me apo pa prind;
- Asistentë psikologë tek Qendrat e shëndetit publik/spitale (përkrah mjekeve);
- Psikolog me formim të përgjithshëm pranë organizatave jofitimprurëse që mbulojnë projekte/programe psiko-sociale.

Universiteti Europian i Tiranës
maiora premunt / gjëra të mëdha na presin

QAA GLOBAL
Institution accredited
European University of Tirana
Valid 12/2022 – 12/2027

# BACHELOR "PSIKOLOGJI" 180 ECTS
## PROFILI: SHËNDET MENDOR

| Nr. | Viti | Sem | Emri i lëndës | ECTS |
|---|---|---|---|---|
| **A - LËNDË BAZË/ 15-20%/32 ECTS** | | | | |
| 1 | I | 1 | Hyrje në sociologji | 6 |
| 2 | I | 1 | Hyrje në filozofi | 6 |
| 3 | I | 1 | Shkrim akademik dhe Metoda kërkimi | 8 |
| 5 | I | 2 | Statistikë | 6 |
| 6 | II | 1 | Hyrje në ekonomi | 6 |
| | | | | 32 |
| **B - LËNDË KARAKTERIZUESE TE PROGRAMIT 50-55%/96 ECTS** | | | | |
| 1 | I | 1 | Hyrje në psikologji | 6 |
| 2 | I | 2 | Psikologji e personalitetit | 8 |
| 3 | I | 2 | Psikologji organizative | 6 |
| 4 | II | 1 | Psikologji zhvillimi | 10 |
| 5 | I | 2 | Psikologji sociale | 6 |
| 6 | II | 1 | Hyrje në këshillim | 8 |
| 7 | II | 2 | Hyrje në psikopatologji | 6 |
| 8 | II | 2 | Psikologjia dinamike | 6 |
| 9 | II | 2 | Hyrje në psikologji shëndeti | 6 |
| 10 | II | 2 | Bazat e edukimit special | 6 |
| 11 | III | 1 | Psikologji ligjore | 6 |
| 12 | III | 1 | Biopsikologji | 6 |
| 13 | III | 1 | Psikologji konjitive | 8 |
| 14 | III | 1 | Hyrje në psikologji klinike | 8 |
| | | | | 96 |
| **C - LËNDË NDËRDISIPLINORE / INTEGRUESE /12-15%/24ECTS** | | | | |
| 1 | II | 1 | Hyrje në komunikim | 6 |
| 2 | II | 2 | Histori bashkëkohore | 6 |
| 3 | II | 2 | Sjellje konsumatore | 6 |
| 4 | III | 1 | Reklama | 6 |
| 5 | III | 1 | E drejta familjare | 6 |
| 6 | III | 1 | Komunikim ndërkulturor | 6 |
| 7 | III | 2 | Komunikim organizativ | 6 |
| | | | | 24 |
| **D - LËNDË PLOTËSUESE/ 10% - 15%/ 18 ECTS** | | | | |
| 1 | I | 2 | Anglisht | 5 |
| 2 | I | 1 | Bazat e informatikës | 4 |
| 3 | III | 2 | Hartim dhe menaxhim projektesh | 6 |
| 4 | III | 2 | Praktikë dhe zhvillim karriere | 6 |
| | | | | 21 |
| **E - DETYRIME PËRMBYLLËSE/ 3% - 5%/ 7 ECTS** | | | | |
| 1 | III | 2 | Punimi i diplomës/ Provimi Përgjithshëm Përfundimtar | 7 |